



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"

НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
KËSHILLI KOMBËTAR I PAKICËS NACIONALE SHQIPTARE
Бр. 126-117
Nr. 06.04. 2017 год.
Бујановац - Вијапос VIII.



MARËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Gjilan, më 6.4.2017
ndërmjet:

- Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, të cilën e përfaqëson Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor (tani e tutje si UKZ).
- dhe
- Këshillit Kombëtar Shqiptar, të cilin e përfaqëson z. Jonuz Musliu, Kryetar (tani e tutje si KKSH).

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi profesional për trajnimin e mësimdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme të Luginës së Preshevës (Preshevë, Bujanoc, Medvegjë) si dhe aspekte tjera përgatitjen e kuadrove të reja në fushën arsimit; Bashkëpunimi në mes të palëve rreth kuotave të regjistrimit të studentëve të rinj në UKZ; Vendosja e kritereve për aplikim për studentë të rinj nga Lugina në UKZ, organizimi i tryezave të përbashkëta debatuese, organizimi i konferencave të përbashkëta, si dhe bashkëpunime të tjera të cilat mund të ndërlidhen me aspektin e edukimit.

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

Fushëveprimi i bashkëpunimit

I. Trajnimi i mësimdhënësve

- (a) Universiteti "Kadri Zeka" do të bëjë aftësimin dhe trajnimin e mësimdhënësve në aftësim profesional pa shkpuntje nga Puna, sipas kërkesave të KKSH.
- (b) Trajnimi do të udhëhiqet nga profesorë kompetent të UKZ-së, gjegjësisht nga profesorë të Fakultetit të Edukimit.
- (c) UKZ do të hartojë planin e trajnimit, ndërsa KKSH do të plotësojë kushtet për realizimin e trajnimit.
- (d) KKSH do të shënojë dhe trajtojë aspektin e kornizës ligjore dhe çështjet administrative.
- (e) UKZ dhe KKSH do të rregullojë procedurat për njohjen e programeve të caktuara studimore dhe certifikimeve profesionale dhe bashkërisht do të jalin certifikatën si dëshmi të pjesëmarrjes në trajnim.

II. Bashkëpunimi për regjistrim të studentëvë të rindj

- (a) UKZ ka përcaktuar dhe vazhdon të përcaktojë kuota të rezervuara për regjistrimin e studentëve të rindj që vijnë nga Komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.
- (b) Kandidatët të cilët aplikojnë nga Lugina e Preshëvës, përveç dokumenteve identifikuuese (letërnjoftimit) duhet të kenë edhe shkollimin e mesëm të kryer në Luginë.
- (c) Nëse kandidati nuk ka numër personal në certifikatë, duhet të sjell një deklaratë, të lëshuar nga KKSH, që vërteton së kandidati në fjalë është banor i Luginës.

III. Zbatimi

UKZ dhe KKSH angazhohen bashkërisht:

- (a) Të promovojnë bashkëpunimin akademik dhe profesional ndërmjet dy institucioneve për zbatimin e këtij Bashkëpunimi;
- (b) Të përcaktojnë një person kontaktues për aktivitetet individuale dhe grupore dhe të planifikojnë koordinimin e të gjitha aktiviteteve brenda institucioneve të tyre; dhe
- (c) Të takohen në bazë periodike për të rishikuar dhe vlerësuar aktivitetet e kaluara.

IV. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e tij, si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si:

- a) Ndryshimet ose plotësimet e marrëveshjes do të janë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre.
- b) Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë program të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të janë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

V. Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje lidhet me kohë të caktuar. Kohëzgjatja e zbatimit të bashkëpunimit do të përcaktohet në bazë të fondeve në dispozicion për të dy institucionet si dhe në bazë të asistencës financiare që mund të realizohet nga burimet e jashtme.

Përfundimi i këtij bashkëpunimi mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga njëra palë me paralajmërim prej së paku tre muajsh.

Marrëveshjet gojore për çështje të caktuara, gjithashtu nuk gjejnë mbështetje në këtë Marrëveshje dhe ato nuk do të merren parasysh.

VI. Mospajtimet


Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

VII. Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje, për secilën palë nga një.


Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë:

Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor

Këshilli Kombëtar Shqiptar



Jonuz Musliu, Kryetar KKSH